Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 279/20
Datë/Datum 11.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	13.05.2019	*10.06.2020*	279/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 18.02, OE :" **D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk**", ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**279/20** në lidhje me aktivitetin e prokurimit "**Ri-shpallje- Mirëmbajtje e autorrugëve pjesa I-rë – Mirëmbajtje dimërore e rrugëve urbane**" me nr. të prokurimit: **632-19-7809-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Gjakovë.

Data e njoftimit për kontratë 16.10.2019, data e parashikuar e hapjes së ofertave 05.11..2019, data e kërkesës për rishqyrtim 23.04.2020, vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim 27.04.2020.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Grupi i OE: "D & T Group & Florida & Horn & Co Kosova shpk" ushtron të drejtën e saj ligjore që përmes ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit të ja mundësoj AK Komuna e Gjakovës që vendimin e shpallur ta anulon dhe të na shpallë konzorciumin tonë fitues të projektit të lartëcekur.

Konzorciumi ynë jemi eliminuar me arsyetimin se kinse nuk kemi referenca të mjaftueshme, dhe ne konsiderojmë se kjo aspak nuk qëndron si fakt, sepse pas analizimit të dokumenteve të dorëzuara pranë AK Komuna e Gjakovës dhe dorëzimit të kërkesave për sqarim ne e kemi vërtetuar se AK-Komuna e Gjakovës prapë ka marrë vendim të pa drejtë me rastin e eliminimit tonë, pasi që referencat e dorëzuara nga kompanitë tona janë të sakta dhe të dëshmuara edhe me prova- kontrata me rastin e kërkesës për sqarim nga AK, ku disa prej tyre po i potencojmë në vazhdim dhe po ashtu janë të bashkangjitura edhe në dosjen tonë:

1. Referenca me Komunën e Gjakovës "Mirëmbajtja e Autorrugëve-Lot 1" vlera (47,300 +30% e

vlerës) total 61,490.00 Euro;

2. Referenca e kompanisë FLORIDA sh.p.k "Mirëmbajtja rutinë dhe dimërore në aksin rrugorë Bajram Curr-Fierzë" në vlerë 205,000.00 Euro;

3. Referencat e NOTI BETON "Ndërtimi i kolektorit betonarme dhe kanalizimi fekal" në vlerë 412,376.72 Euro;
4. Referenca e Komuna e Gjakovës "Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni lot II" në vlerë 76,288.00, dhe
5. Kontrata "Sanimi dhe Ndërtimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes" e vitit 2018-2019 referenca e dorëzuar pranë AK Komuna e Gjakovës në vlerë 77,847.00 Euro

Dhe të gjitha referencat tjera të anëtarëve tonë të konzorciumit në këtë project: "Horn & Co Kosova" dhe "Florida" sh.p.k të cilat janë të futura në dosjen e tenderit ku dëshmohet qartë se ne i tejkalojmë kërkesat sipas pikave 9.1 & 9.2 të FDT.

Ne për të gjitha këto që i precizuam më lartë i kemi dërguar edhe sqarimet tona pranë AK Komuna e Gjakovës dhe mendojme se AK Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje të ligjit të prokurimit LPP-së me rastin e rivlerësimit të tenderëve duke na eliminuar pa të drejtë.

Vlenë të theksohet se kompania jonë "D & T Group" sh.p.k kemi pasur kontratë në vitin 2018-2019 me AK Komuna e Gjakovës për tenderin me titull: "Mirembajtja e Autorrugëve Lot 1" ku këtë projekt e kemi përfunduar me sukses të plotë në çdo gjë që ka dal nga procesi kontraktual, dhe këtë shumë qartë e dëshmon edhe referenca e lëshuar nga AK Komuna e Gjakovës.

- Prandaj ne nuk e kuptojmë vendimin e AK Komuna e Gjakovës, sepse prapë jemi eliminuar pa të drejtë nga gara ku shihet edhe nga dokumentacioni i prezantuar në dosje të lëndës që i kemi të gjitha dokumentet e kërkuara sipas dosjes së tenderit, si dhe të gjitha pajisjet në dispozicion duke filluar nga ato më të voglat pasi që jemi të vetedijshëm se qyteti i Gjakovës ka rrugica të cilat nuk bën assesi të pastrohen me pajisje të mëdha, pasi që 70% e rrugëve duhet të pastrohen me Mini pajisje për shkak të rrugëve të ngushta, kurse rrugët kryesore me pajisje të mëdha, çka do të thotë se i posedojmë edhe pajisjet e mëdha edhe të voglat për mirëmbajtje dimërore të rrugëve.

Ne do ti japim disa nga përgjigjet tona në 5 arsyet e eliminimit tonë nga gara:
Pretendimit nr 1:1 kemi dhënë sqarimet tona edhe pranë AK me shkrim, por po i cekim edhe në këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.Realizimi i projektit për kompaninë Noti Beton me titull "Ndërtimi kanalizimi në rrugën mbi lumin Prishtina", ku punimet janë realizuar në gjithë gjatësinë e rrugës disa km, ku gjithashtu është mirëmbajtur rruga gjatë punimeve dhe e njejta është kthyer në gjendje të mëparshme,prandaj ne konsiderojmë që është punë e ngjashme sipas kërkesës se AK, sepse e njejta referencë është pranuar nga AK Komuna e Gjakovës si punë e ngjajshme në vitin 2018 për tenderin Mirëmbajtja e Autorrugëve , kurse tash po e njejta nuk

pranohet si punë e ngjashme po nga i njejti AK Komuna e Gjakovës.
Sa i përket eksperiencës së kompanisë tonë për këtë kontratë, ne e kemi dëshmuar sepse i kemi referencat-kontratat të cilat i ka lëshuar edhe vet AK Komuna e Gjakovës ku e kemi bërë për dy (2) vite mirëmbajten e rrugëve të qytetit të Gjakovës konkretisht gjatë 2018-2019.

Pretendimi nr 2: Kontrata e lidhur në mes të MBPZHR është bërë kyçja e ngrohjes me gypa jashtë objektit, prandaj janë hapur kanale gjatë rrugës me çka konsiderojmë se është punë e ngjashme sipas kërkesës se AK.

Pretendimi nr 3: Kontrata "Ndërtimi, sanimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes" është realizuar në vitin 2018 dhe 2019 në vlerë prej 77,847.00 euro, për të njejtën e kemi kërkuar referencën pranë KK Gjakovë por e njejta na është vonuar, prandaj AK në sqarim ka kërkuar referencë dhe të njejtën e kemi bashkangjitur në sqarim, ne mendojme se AK ka mundur ta verifikojë edhe vet se në cilën kohë janë përfunduar punimet e kontratës së lartë cekur, sepse është dokument i lëshuar nga vetë AK Komuna Gjakovë.

Pretendimi nr 4: Grupi ynë i OE: "D & T Group shpk & Florida shpk & Horn & Co Kosova shpk" nuk kemi dorëzuar/ngarkuar asnjë kontratë të lidhur në mes të Florida sh.p.k dhe D&T Group sh.p.k në sistemin e e-prokurimit siç pretendon AK Komuna e Gjakovës, të njejtën ju kemi dërguar në momentin kur keni kërkuar sqarim. Në e-prokurimi ne kemi dorëzuar/ngarkuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, listen e kontratave dhe referencat e tyre kja mund te verifikohet, por ju rikujtojmë se ne me kompaninë Florida sh.p.k kemi disa marrëveshje bashkëpunimi, prandaj disa prej tyre janë në implementim e sipër p.sh (Marreveshja e dates 30.12.2017 është në realizim e sipër), kurse marrëveshja sipas referencës së dorëzuar në sistemin e e-prokurimi e dates 22.11.2016 është e përfunduar, këto sqarime ju kemi dhen edhe ne kerkesen e AK Komuna e Gjakoves.

Prandaj AK pretendon se ne kemi dorëzuar në e-prokurimi ndonjë kontratë tjetër kjo nuk qëndron aspak, pasi qe në e-prokurimi ne kemi dorëzuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit listën e kontratave dhe referencat, kurse në sqarimet e kërkuara pranë AK ne kemi dorëzuar gjitha kontratat.

Po ju sqarojmë dhe këtë pjesë, sa i përket pronësisë së automjeteve kompania jonë ka disa marrëveshje për marrjen e pajisjeve në shfrytëzim me disa kompani, e njëra nga ato marrëveshje është edhe ajo me kompaninë Horn & Co Kosova sh.p.k e nënshkruar për vitet 2016- 2024, ku i kemi gjitha pajisjet e dhëna në shfrytëzim pa limit, e me këto pajisje ne jemi angazhuar si nënkontraktor te kompania Florida sh.p.k. Nëse ka qenë kjo njëra ndër arsyet reale të eliminimit tone atëherë pse nuk e keni kërkuar edhe këtë në sqarim me ç'rast ne do ju kishim dërguar, gjithashtu ju si AK keni mundësi të verifikoni çdo referencë nëse keni dyshime të tilla por shihet

qartë se vlerësimi i këtij projekti nuk është bërë në bazë të dokumenteve dhe fakteve të prezantuara por në bazë të hamendjeve dhe bindjeve personale.

Ju ritheksojmë prapë se Grupi ynë i OE i tejkalojn të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit FDT për pajisjet dhe referencat e kërkuara prandaj kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta anuloj për herë të dytë rekomandimin për dhënie të kontratës dhe ta rekomandoj AK Komuna e Gjakovës që të shperblejë grupin tonë të OE me kontratë.

- Pretendimi nr.5: Është për keqardhje se si kompania jonë nuk ka arritur ta bindë AK se e njejta e plotëson kushtin e liderit të grupit të konzorciumit, ku njëra nga kontratat e realizuara siç e cekëm edhe më lartë është "Mirembajta e Autorrugëve LOT 1" e realizuar me sukses në vitin 2018-2019 ku e keni referencën të lëshuar nga AK Komuna e Gjakovës , ne mendojmë dhe jemi shumë të bindur (ngase kemi fakte) se i plotesojmë dhe i tejkalojmë kërkesat sipas dosjes së tenderit 9.1 & 9.2 të FDT. Ne jemi të shqetësuar më shumë se si e ka bindur grup i OE-së te cilen AK Komuna e Gjakoves e ka rekomanduar per kontrate se mund ta realizoj kontratën me sukses, ku oferta e tij është 42% më shtrenjtë se oferta jonë, dhe gjithashtu kanë kontratë me AK Komuna e Gjakovës për mirëmbajtjen autorrugeve nga bora në 86 fshatra (LOT 2) e cila është valide deri në dhjetor 2021 ,prandaj ne jemi kurreshtarë të dijmë se në çfarë forme e ka bindur OE i rekomanduar per kontrate AK Komunën e Gjakoves se mund ta realizojë kontraten LOT 1 me
sukses, si do ti ndajë pajisjet e njejta në të njejtën kohë në dy vende të ndryshme në një hapësirë 580 km2 aq sa ka komuna e Gjakoves? ku dihet qartë se në pastrimin e rrugëve nga bora.

makineritë duhet të jenë në gjendje gatishmërie 24 h,me nje reagim shumë të shpejtë dhe emergjent, pasi që nuk ka tolerancë për vonesa.

- Grupi ynë i OE: "D & T Group & Florida & Horn & Co Kosova shpk" kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta anuloj njoftimin për dhënje të kontratës, dhe ta rekomandoj AK Komuna e Gjakovës që grupi yne D & T Group sh.p.k & Florida sh.p.k & Horn & Co Kosova sh.p.k
  të shpallemi fitues të kësaj kontrate për arsye se i plotësojmë të gjitha kushtet sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Me të gjitha verifikimet e lartë cekura konstatojmë se është shkelur ligji i LPP nr.04/L-042, dhe jane shkelur dispozitat:

- Neni 1 par. 1 dhe 3 te Ligjit Nr.04/L-042 Qëllimi:
- Neni 6 par. 2 i Ligjit Nr 04/L-042 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 par. 1 dhe 4 te Ligjit Nr.04/L-042 Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi
- Neni 51 te LPP-së nr. 04/L-042 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52 par.4 i LPP-së nr. 04/L-042 Njoftimi i Kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 te LPP-së nr.04/L-042 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

- Neni 59 par.2 dhe 4 te Ligjit nr.04/L-042 Ekzaminimi,Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve
- Neni 60 par.2 i Ligjit Nr 04/L-042 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72 par.3 Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 450.000,00€, në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për 3 (tri)** **vitet e fundit (kopje)**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se ë.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës,** **shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten** **referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve**
		Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 20 (njëzet) punëtorë fizik për pastrim te trotuareve, shkallëve, thyerje te akullit-largim te sllomave, hapje deri te puseta e ujëmbledhëseve etj. ku ka	**Lista e personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore duke e dëshmuar me kontrata të** **punës (Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt). Lista e prezentuar të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga Operatori Ekonomik.**

		nevojë për kryerjen e shërbimeve.	
		Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë a.) **4 kamiona** me mekanizem për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës b.) **2 pastrues** të borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës, i vogël (mini) c.) **2 kamiona** transportues për bartjen e borës nga rrugët dhe trotuaret me peshë totale minimum 7t d.) 2 eskavator ose ngarkues me lopat	Lista e mjeteve-paisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit). Operatori Ekonomik duhet të sjell dëshmi njërën prej këtyre dokumenteve kopje të librezës së qarkullimit, DUD doganorë, faturë për blerjen ose kontrata mbi qiramarrjen të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (kopje).

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Në bazë të kritereve të përcaktuara në Njoftimi për Kontratë dhe dosjes së tenderit, Komisioni për vlerësimin e ofertave i emëruar nga Kryetari i Komunës së Gjakovës me Vendimin e datës 11.02.2020, i cili filloj punën me 11.02.2020.

Komisioni i vlerësimit pas verifikimit, ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave me dt.06.04.2020 kërkoi që në bazë të nenit 72 të LPP-së, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nga Operatorët Ekonomik që në afat prej 2 (dy) ditësh (deri të mërkurën, dt. 08/04/2020, në ora 16:00), që në detale të na sqaroni mungesën e dokumentacionit për aktivitetin e prokurimit Titulli: "Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë - Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane", Numri i prokurimit 632-19-7809-2-1-1, Numri i brendshëm 632-18-072-211, për Operatorët Ekonomik:
(Grup i Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; Florida Sh.p.k.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Grup i Operatorëve Ekonomik Company Murseli SH.P.K.; N.SH.T. VIKTORY COM)

Me dt.10.04.2020 u mblodh Komisioni i vlerësimit ku pas ekzaminimit të dokumentave të kërkuara nga Operatorët Ekonomik konstatoi si në vijim:

Për grupin e operatorëve D&T Group SH.P.K.; Florida Sh.p.k.; Horn & Co. Kosova SH.P.K.:

1. Kemi kërkuar: Referenca e lëshuar nga SH.P.K. "NOTI BETON", të sqarohet se për çfarë punime bëhet fjalë (a është kontratë e natyrës së njëjtët? a ka mirëmbajtje të rrugëve në këtë kontratë?), të bashkëngjiten dëshmitë që tregojnë se ka qenë kontratë e punimeve të natyrës së ngjashme siç është ky tender Kemi konstatuar: Kontrata e lidhur në mes të SH.P.K. "NOTI BETON" dhe INOVA shpk & D&T Group, përkatësisht neni 2 i saj tregon se palët janë dakorduar për ndërtim të kolektorit të betonarme dhe kanalizimit fekal në rrugën mbi lumin Prishtina, - ky aktivitet i prokurimit kërkon që operatori të ketë eksperiencë në mirëmbajtje të rrugëve. Ju nuk keni ofruar dëshmi që gjatë implementimit të kësaj kontrate keni kryer punë të tilla.
2. Kemi kërkuar: Referenca e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me dt. 23.10.2019 të sqarohet se për çfarë punime bëhet fjalë (a është kontratë e natyrës së njëjtët? a ka mirëmbajtje

të rrugëve në këtë kontratë?)
Kemi konstatuar: Referenca dhe Kontrata e lidhur në mes të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe D&T Group, nuk ka as një dëshmi që D&T Group ka kryer punë në mirëmbajtje të rrugëve apo hapësirave publike. Ka ofruar vetëm një deklaratë me shkrim në të cilën pohon se ka kryer punë në kthimin e gjendjes së më pashme të rrugëve, mirëpo deklarimin nuk e ka mbështetur me dëshmi siç janë pozicionet e paramases në kontratë.

3. Kemi kërkuar: Për kontratën me nr. 02/410/04-30828 te dt. 08.11.2018 "Sanimi dhe Ndërtimi i Pendave te Kanaleve te Ujitjes" të tregohet se a është kontratë e natyrës së njëjtët (a ka mirëmbajtje të rrugëve në këtë kontratë?), po ashtu mungon referenca andaj ju lutem qe ta na siguroni referencën ne fjale;,
Kemi konstatuar: Në kontratën me nr. 02/410/04-30828 te dt. 08.11.2018 "Sanimi dhe Ndërtimi i Pendave te Kanaleve te Ujitjes" të Komunës së Gjakoves, nuk ka as një pozicion të mirëmbajtës së rrugëve, në sqarime ju keni bashkangjitur referencën e cila është lëshuar pas datës së mbylljes së aplikimit për këtë tender 05.11.2019, përkatësisht referencat janë të datës 07.02.2020 dhe 02.03.2020.

4. Kemi kërkuar: Referenca e lëshuar nga "FLORIDA" sh.p.k., me dt.28.12.2017 për D&T Group e bazuar në kontraten e nënshkrua në mes të Florida shpk dhe D&T Group e cila është e datës 30.12.2017, ndërsa kontrata me titull ''Mirëmbajtja Rutinë e Dimërore Rruga Bajram Curri – Firze, U. Dushaj – Sheshi i Trageteve, Sheshi i Trageteve – Lekbibaj 31.5 km'' e lidhur në mes të "FLORIDA" sh.p.k. dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar (DRV) tregon se ka përfunduar me datë 23.12.2017, si është e mundur që kontrata në mes të Florida shpk dhe D&T Group është nënshkruar pasi që ka përfunduar kontrata e Florida shpk me Autoritetit Rrugor Shqiptar (DRV)?! Operatori Florida shpk referon se D&T Group ka kryer punime si nën kontraktor, për këtë shërbim operatoret kanë lidhur kontratë pas skadimit të kontratës bazë! Ju lutemi të na sqaroni këtë kontraktim?
Kemi konstatuar: Kemi të bëjmë me ndryshim material, pra në sqarime është sjellur kontratë me datë tjetër nga ajo që është dorëzuar në e-prokurim, për këtë keni deklaurar edhe ju se keni bërë lëshim. Mirëpo nëse e analizojmë tutje këtë kontratë pika e parë e marrëveshjes juaj me Florida shpk është të kryeni të gjitha shërbimet e pastrimit të rrugëve nga bora, Ju si operatorë nuk keni as një dëshmi që posedoni makineri për kryerjen e punëve të tilla, si ka mundësi që i keni kryer punë në vlerë 205,000.00 €!

5. Kërkohet nga lideri i këtij konserciumi deklarim me shkrim se a e plotëson kushtin si lider i grupit siç është kërkuar në FDT (pika 9.1 & 9.2 te pjesa e kantatave), nëse po, të sqarohen vlerat e referencave (totali i tyre) dhe natyra e punëve të tyre (referencat duhet të përmbajnë kontrata në të cilat është kryer shërbim në mirëmbajtje të rrugëve).
Kemi konstatuar: Se keni bashkangjitur një kontratë me titull ''Mirëmbajtja rutinë e dimërore Rruga Ura e Bujanit – Qafë morinë, Sopot Kernaj, Mejdan – Tropoje – Buçaj 30.76 km'', kjo kontratë prapë është shtim material sepse nuk rezulton në listën tuaj që e keni dorëzuar në e-prokurim.
Konstatim:
Operatori D&T Group si lideri i këtij koncerziumi, me dëshmitë e ofruara edhe pas sqarime shtesë të kërkuara, nuk na ka bindur se e plotëson kushtin minimal me qenë lider i grupit ashtu siç është kërkuar në pikat 9.1 & 9.2 të FDT-ës, pra nuk ka dëshmuar me referenca se ka kryer punë në vlerë minimale të kërkuar dhe të natyrës së njëjtë siç është kërkuar në FDT.
Për grupin e Operatorëve Ekonomik Company Murseli SH.P.K.; N.SH.T. VIKTORY COM
Kemi kërkuar: Në bazë të listës tuaj cilat pajisje dëshmi i përgjigjen pajisjeve, kërkojmë sqarime mbi specifikimet teknike dhe dëshmi vetëm për pajisje e lartë shënuara, jo pajisje që nuk janë kërkuar, jo për pajisje shtesë, vetëm për pajisje nga pika a.) deri te pika d.)
Pas pranimit të sqarimit kemi konstatuar: Keni bërë një sqarim me shkrim ku keni specifikuar makinerit e ofruara për këtë tender, nga kontrollimi i dëshmive, përveç qç keni bashkangjitur dokumente të pa nevojshme dhe të shumta, të cilat nuk korrespondojnë me kërkesën e pikës 9.1 & 9.2, ju nuk keni arritur të na bindi se

keni në dispozicion 4 kamiona me mekanizëm për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës. Me kombinimin e dokumenteve që kemi bërë duke kombinuar lugët dhe hedhësit e kripës, kemi arritur të identifikojmë vetëm 2 kamion me mekanizëm për pastrim të borës dhe shpërndarje të kripës dhe atë duke e marrë të mirëqenë faktin se këto pajisje do të montohen në kamionët që keni ofruar.
Konstatim: Lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion të cilën e keni dorëzuar përmes platformës së e-prokurimit, nuk është sipas kërkesës së FDT-ës përkatësisht pikës 9.1 & 9.2. në të keni shënuar makineri të pa specifikuara (psh. Tipi, tabelat e regjistrimit etj). Për këtë kemi kërkuar sqarime, nga sqarimi i kërkuar, ju keni sjellë deklaratë dhe listë të pajisjeve për pikën a, b, c dhe d mirëpo prapë nuk keni arritur të dëshmoni zotimin tuaj se posedoni këto makinerinë-pajisjet ashtu siç është kërkuar në pikën 9.1 & 9.2. të FDT-ës.
Konsiderojmë se grupi i Operatorëve Ekonomik Company Murseli SH.P.K.; N.SH.T. VIKTORY COM nuk i plotëson kërkesat minimale për mjetet-pajisjet teknike për realizimin e kësaj kontrate.
Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave konstatoi se si Operatorë Ekonomik më i suksesshëm është Grup i Operatorëve Ekonomik SH. Drini Company SH.P.K.; BERISHA COM SH.P.K, ku komisioni i vlerësimit e rekomandon për dhënie të kontratës ,pasi që është ofertuesi i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët me peshim

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARANGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues i OSHP-së me datë 30.01.2020, ka nxjerrë vendimin numër 941/19.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "D&T Group & Florida"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimorë mbi arsyet e eliminimit të OE ankues, AK-KK Gjakovë me rastin e rivlerësimit konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues dhe vendimit të panelit shqyrtues nr.933-952/19 ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, dhe pas pranimit të përgjigjeve/sqarimeve AK-komisioni vlerwsues ka vlerësuar se OE nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket kontratave për punë të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit si dhe nuk plotëson kërkesat për pajisje.

Pas analizimit të raportit të komisionit rivlerësues dhe ofertës së OE ankues, vlerësojmë se OE ankues nuk plotëson kërkesat minimale sa i përket punëve të ngjashme në tri vitet e fundit.
Nga lista e projekteve të ofruar nga OE ankues në ofertën e tij, shumica e projekteve nuk janë të natyrës së ngjashme me natyrën e kësaj kontrate dhe OE nuk e arrinë vlerën e kërkuar prej 350,000€.
Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.
Gjitha detajet tjera lidhur me plotësimin e kërkesave minimale nga OE ankues gjenden në raportin e komisionit vlerësues të shënuar më lart.

Përgjigje në pretendimin nr.2
Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, pretendimi kryesor është se OE I rekomanduar për kontratë të njëjtën makineri ka ofruar në të dy lotet dhe kështu e ka të pamundur realizimin e kontratës.

Pas nalizimit të ankesës, dosjes së tenderit, dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, fillimisht qarojmë se me rastin e ritenderimit janë zvoguluar kërkesat për kapacitet teknik/professional sa I përket pajisjeve/makinerisë.

Me rastin e ritenderimit nga 11 kamiion sa ishin kërkuar me rastin e publikimit të parë, tani në dosje janë kërkuar gjithsej 6 kamion. Ndërsa edhe për lot.2 të për të cilin ka nënshkruar kontratë OE janë kërkuar 6 kamion, që në total I bie se nevojiten 12 kamion për plotësimin e kërkesave të AK-së për të dyja lotet.

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nga listat e pajisjeve që ka ofruar OE janë gjithsej 15 kamion. Do thotë në qfardo rrethane OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën e AK-ë.

Po ashtu nga 3 pastrues bore mini, sa ishin kërkuar herën e parë për lot.1, tani kërkohen vetëm 2, ndërsa në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë i njëjti ofron 5 pastrues bore mini.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë edhe në këtë pikë është i pabzuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për dhënie të kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – UP
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues –D&T Group&Florida&Horn&Co Kosova